

AKT THEMELIMI I SHOQËRISE TREGTARE "AM BOTANICALS SHPK"

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe në zbatim të ligjit nr.9723 datë 03/05/2007 "Për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit", ligjit nr.129/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, sot me datë 31/08/2024 bëhet themelimi i Shoqërisë "AM BOTANICALS SHPK" me seli në adresën: Zona Kadastrale 8525, Nje Hyrje, Pall 574/3 K 5, Ap.15, Elbasan, Shqiperi nga ortakut i vetëm i kësaj shoqërie Z.Aldo Millona i datëlindjes 09/10/1984 lindur në Durrës e banues në Elbasan i pajisur me kartë identiteti me numër 036023827 me numër personal I41009067T.

VENDOSI

Të krijojë një Shoqëri Tregtare të emërtuar "AM BOTANICALS" SHPK me kushtet si më poshtë:

NENI 1 (THEMELIMI)

1.1 Themeluesi në cilësinë e ortakut të vetëm krijon Shoqërinë Tregtare "AM BOTANICALS" SHPK me statusin juridik të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në kuptimin e ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ligjit nr.129/2014 me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin në para.

NENI 2 (STATUSI LIGJOR)

2.1 Shoqëria gëzon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do të rregullohet nga Legjislacioni Shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe statutin e bashkëlidhur.

NENI 3 (EMRI)

3.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "AM BOTANICALS" SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria"). Emër ky që do të shënohet në të gjitha dokumentat, letrat, faturat, etj.

3.2 Shoqëria ka vulën e saj në të cilën është shkruar "AM BOTANICALS" SHPK


NENI 4 (SELIA)

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Zona Kadastrale 8525, Nje Hyrje, Pall 574/3 K 5, Ap.15, Elbasan, Shqiperi.

4.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi Administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 5 (KOHËZGJATJA)

5.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.



NENI 6 (OBJEKTI I SHOQERISE)

6.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

6.1.1 Grumbullimin, perpunimin, magazinim, kultivim, tregtimin me shumice e pakice ,eksport-import te Bimeve Aromatike dhe Medicinale, Erezave, Lendeve te Para etj. Tregti import,eksport, me shumice e pakice, mallra industriale, ushqimore, etj. Aktivitete financiare nepermjet komisioneve dhe sistemit te brokerimit.

6.1.2 Transport kombëtar e ndërkombëtar i mallrave dhe udhetarëve për vetë e të treta.

6.1.3 Kryerja në përgjithësi e çdo operacioni financiar, tregtar e industrial me pasuri të paluajtshme ose të luajtshme që mund të lidhen drejtëpërdrejt ose tërthorazi me një nga objektet e shoqërisë.

6.1.4 Grumbullim, magazinim, perpunim, tharje, tregtim me shumice e pakice import-eksport fruta – perime, etj.

6.1.5 Importim-eksportim, përpunim dhe tregtimi me shumice dhe pakice i kafese dhe nenprodukteve te saj.

6.1.6 Prodhimin, paketimin dhe tregtimin brenda dhe jashte vendit i esencave dhe vajrave esencial te llojeve te ndryshme nga Bimet Medicinale Aromatike etj.

6.1.7 Shoqëria mund të kryejë aktivitete dhe shërbime si një kompani e mirëfilltë brokerimi ose tregëtare bazuar në kompesime nëpërmjet komisioneve që burojnë nga e drejta që i lind Shoqërisë nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara midis dy ose më shumë palëve vendase ose të huaja, të dakordësuara sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit për shërbimin e ofruar nga Shoqëria.

6.2 Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria:

6.2.1 Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse;

6.2.2 Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë truall apo objektesh.

6.2.3 Mund të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve nëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre.

6.3 Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të li dhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

6.4 Shoqëria mund të kryejë aktivitete dhe shërbime si një kompani e mirëfilltë brokerimi ose tregëtare bazuar në kompesime nëpërmjet komisioneve që burojnë nga e drejta që i lind Shoqërisë nëpërmjet marrëveshjeve të nënshkruara midis dy ose më shumë palëve vendase ose të huaja, të dakordësuara sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit për shërbimin e ofruar nga Shoqëria.



NENI 7 (NDRYSHIMET)

7.1 Me vendimin e themeluesit të saj Shoqëria mund të ndryshojë emrin,selinë,formën juridike dhe objektin e veprimtarisë, mbas bërjes se ndryshimeve përkatëse ne këtë Akt Themelim dhe ne Statut.

NENI 8 (KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË)

8.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (Një qindë mije) Lekë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku që zotëron 100 % (njëqind përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht:

- Z. Aldo Millona shtetas shqiptar, i lindur në Durres, më 09.10.1984, identifikuar me pasaportën me nr. BJ 6146908 dhe numër personal I 41009067 T, i cili zotëron 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar.

8.2 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortaku do të ketë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

NENI 9 (VEPRIMTARIA)

9.1 Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj administruese , ekonomike, financiare në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe dispozitat e Statutit të Shoqërisë. Shoqëria do të drejtohet nga organet drejtuese që përbëhen nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori. Themeluesit me vendim të veçantë do të emërojnë edhe një ekspert kontabël. Shoqëria do të mbajë llogaritë në përputhje me ligjin " Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe do të krijojë fondin rezervë.

9.2 Fitimi neto që do të rezultojë ne fund të çdo viti financiar pas zbritjes së fondit rezervë dhe humbjeve të mbartura nga vitet e mëparshme do ti kalojë ortakëve.

NENI 10 (ORGANIGRAMA)

10.1 Përcaktimi i strukturës organizative të Shoqërisë, numri i punonjësve, emërimet dhe shkarkimet në organet e saj bëhen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

10.2 Administrator i Shoqërisë emërohet Z.Aldo Millona i datëlindjes 09/10/1984 lindur në Durrës e banues në Elbasan i pajisur me kartë identiteti me numër 036023827 me numër personal I41009067T.

10.3 Marrëdhëniet e punës do të bazohen në kontratat e punës të lidhura mbi bazën e legjislacionit në fuqi.

NENI 11 (TE TJERA)

Rregullat për drejtimin, organizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë janë përcaktuar ne statutin e kësaj Shoqërie që do ti bashkëlidhet këtij Akt Themelimi.

Data 31/08/2024

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"AM BOTANICALS SHPK"

ALDO MILLONA